



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 791 Prot.

Tiranë, më datë 08.06.2021

VENDIM

Nr. 262, datë 08.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

VENDOSI:

1. Vijimin e punimeve për zbatimin e projektit “Dizenjimi për Rivitalizimin e sheshit “Çerçiz Topulli” dhe Parkim nëntokësor në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës, pas shqyrtimit të relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjike në IKTK;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Dizenjimi për Rivitalizimin e sheshit “Çerçiz Topulli” dhe Parkim nëntokësor në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Pas zbulimit të plotë të strukturës së murit të evidentuar gjatë punimeve, subjekti i licencuar në arkeologji duhet të përgatisë një raport të detajuar, i cili do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR  
Elva MARGARITA

